REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. Regj. 430 Prot.
Date regjistrimi 10.08.2015

Nr. 430 Prot. VENDIMI
Date vendimi 13.08.2015

V E N D I M

Per marrjen e mases te sekuestros konservative

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce, e perbere prej:

Gjyqtare Luljeta KOLE

Asistuar nga sekretare Vasjana Postol, ne Korce me date 13.08.2015 ora 12.30, shqyrtoi ne seance gjyqesore publike ceshtjen penale qe ju perket:

PROKURORISE prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, perfaqesuar nga prokurori Elsion Sadiku.

OBJEKTI: Caktim mase sigurimi pasuror "sekuester konservative"

Baza ligjore: Neni 270 i K.Pr.Penale.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te perfaqesuesit te Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, gjykata pasi degjoi:

Prokurorin qe kerkoi pranimin e kerkeses dhe caktimin e mases se sigurimi pasuror "sekuester konservative" mbi sendet e luajtshme ne pronesi te shoqerise "Beçi Company", "Four Beton", "Kapurani Vjara" subjekte ndaj te cilave eshte filluar procedimi penal per vepren penale te "Fshehjes se te ardhurave", te parashikuar nga neni 180/3 i K.Penal.

Si dhe pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi ceshtjen ne teresi

V Ë R E N

Ne date 10.08.2015 ora 11.00 nga ana e Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce, eshte paraqitur prane kesaj gjykate kerkesa per caktimin e mases se sigurimit pasuror "sekuester konservative" mbi sendet e luajtshme ne pronesi te shoqerise "Beçi Company", "Four Beton", "Kapurani Vjara" bazuar ne nenin 270 te K.Pr.Penale.

Ne baze te neneve 278 dhe 271/1 te K.Pr.Penale, shqyrtimi i kesaj kerkese ne fazen e hetimeve paraprake hyn ne kompetencen lendore dhe tokesore te kesaj gjykate, pasi eshte gjykata ku mendohen te jene kryer veprimet qe i atribuohen te dyshuarit si veper penale.

Nga faktet dhe provat e paraqitura ne seance gjyqesore, rezultoi se mbi bazen e materialit hetimor te ardhur nga Drejtoria e Policise te Qarkut Korce me shkresen nr.819 prot date 22.04.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Korce ka regjistruar procedimin penal nr. 504 te vitit 2015, per vepren penale te "Fshehjes se te ardhurave", parashikuar nga neni 180 i K.Penal.

Nga materialet ne lidhje me kete procedim penal rezulton se Drejtoria e Policise te Qarkut Korçë, ka mare nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit nje informacion per veprën penale te "Fshehjes se te ardhurave", veper kjo e parashikuar nga neni 180 i K.Penal, te kryer nga subjekti "Kapurani Vjara", me administrator shtetasin Foto Kapurani. Sipas këtij informacioni, ky subjekt ne pasqyrat financiare te viteve 2012, 2013, tek zeri inventar mallra per shitje, ka paraqitur shumen 200.239.931 leke, qe sipas librave te shitjes duhet te jete çimento. Sipas bilancit, kjo shoqeri duhet te kete gjendje ne magazinë 30.000 ton çimento, por sipas informacioneve ky subjekt ka paraqitur rrethana të rreme, pasi ai nuk ka gjendje ne magazine.

Gjithashtu ne date 06.05.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Korçe, mbi bazen e materialit hetimor te derguar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Qendror, Tirane, me shkresen nr.1207 prot.date 04.05.2015, ka regjistruar procedimin penal nr. 561 te vitit 2015, per veprat penale te "Krijimit te skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vleren e shtuar" dhe "Fshehjes se te ardhurave", te parashikuar nga nenet 144/a dhe 180/3 te K.Penal.

Nga materialet ne lidhje me keto dy procedime penale, rezulton se behet fjale per kater kompani "Kapurani Vjara", "Kapurani Trans", "Beçi Company" dhe "Four Beton", te cilat dyshohet se jane krijuar nga i njejti person dhe kane sherbyer per te fshehur te ardhurat, duke mos i deklaruar shitjet e tyre, ne nje total prej afersisht 60.000 ton çimento. Tre prej ketyre kompanive kane pezulluar aktivitetin e tyre, megjithese me dokumenta kane pasur gjendje malli te pa shitur, nderkohe qe realisht ato nuk kane gjendje fizike malli. Per te mos u zbuluar nga organet tatimore, shpesh here keto kompani kane kryer shitje fiktive me njera tjetren, sikurse eshte rasti i "Beçi Company" dhe "Four Beton".

Bazuar ne faktet e mesiperme, me vendimin e dates 25.05.2015, Prokuroria ka vendosur bashkimin e procedimeve penale te mesiperme.

Ne vijim te hetimeve ne lidhje me kete procedim penal jane kryer nje sere veprimesh hetimore, nga te cilat ka rezultuar se:
Kater subjektet tregtare "Beçi Company" me Nipt K84614003A me perfaqesues ligjor shtetasin Theodhori Kapurani, "Four Beton" me Nipt L14507001J me perfaqesues ligjor shtetasin Dhimitri Metellari, "Kapurani Trans" me Nipt L23703201G me perfaqesues ligjor shtetasin Enzo Martini dhe "Kapurani Vjara" me Nipt J84015175L me perfaqesues ligjor shtetasin Foto Kapurani, jane krijuar nga i njëjti person, shtetasi Foto Kapurani dhe kanelidhje me njera tjetren, duke u krijuar me qellim per te fshehur te ardhurat, duke mos i deklaruar shitjet e tyre me qellim mospagimin e detyrimeve tatimore, ne nje total prej afersisht 60 mije ton çimento, dhe duke shmangur ne kete menyre nje detyrim tatimor rreth 170 milion leke.

Tre prej ketyre kompanive kane pezulluar aktivitetin e tyre megjithese ne dokumenta kane pasur gjendje malli te pa shitur, dhe pervec kesaj realisht ato nuk kane gjendje fizike malli, qe do te thote se ato kane bere shitje te pa deklaruara. Per te mos u zbuluar nga organet tatimore nje veprimtari e tille, shpesh keto kompani kane kryer shitje fiktive me njera-tjetren, sikurse eshte rasti i "Beçi Company" dhe "Four Beton", ne muajin Gusht te vitit 2014.

Keshtu verifikimet kane nisur me subjektin "Beçi Company", ku nga verifikimet e bera ne bashkepunim me inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Korce, ka rezultuar se ky subjekt nuk ushtronte aktivitet ne adresen e deklaruar ne Korce, Zona Industriale, rruga nacionale Korce-Çiflig, Km.1. pas kesaj, eshte marre informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korce nga ka rezultuar se ne kete subjekt ishte ushtruar kontroll ne muajin Gusht 2014.
Eshte pyetur shtetesja Donika Dimareli, inspektore kontrolli prane Drejtorise Rajonale Tatimore Korce, e cila ka deklaruar se kur eshte filluar kontrolli i subjektit "Beçi Company", ajo ka konstatuar se nuk ushtrohej aktivitet sipas adreses te deklaruar ne QKR. Ajo ka kontaktuar me shtetasin Vangjush Çerepi qe ka qene ekonomisti qe ka mbyllur bilancin e kesaj shoqerie, dhe ai i ka treguar se subjekti ushtronte aktivitet ne Tirane, duke i dhene edhe nje numer kontakti te shtetasit Erion Berberi, i cili ishte ekonomisti aktual i subjektit. Pas kesaj, eshte shkuar ne zyrat e subjektit ne Tirane dhe eshte marre dokumentacioni i nevojshem, po ashtu eshte kryer kontrolli fizik i subjektit ne nje ambjent te ndodhur ne autostraden Tirane-Durres, ne Qafe Zotaj, dhe ishte konstatuar se nuk kishte gjendje çimentoje, por vetem kamiona te parkuar.

Eshte pyetur shtetasi Vangjush Çerepi, i cili ka sqaruar se ka qene ekonomist i subjektit "Beçi Company" dhe ka mbyllur bilancet per periudhen 2010-2012. Ai ishte njoftuar per te kontaktuar me inspektoren e kontrollit tatimor dhe i kishte treguar asaj per adresat qe subjekti kishte ne Tirane, duke i dhene edhe numrin e telefonit te shtetasit Erjon Berberi qe ishte ekonomisti i firmes.

Eshte marre kontakt me shtetasin Thodhori Kapurani i cili eshte aktualisht administrator i subjektit "Beçi Company", dhe eshte shkuar ne zyrat e subjektit e ndodhur ne unazen e re Tirane, dhe nga kqyrja qe ju eshte bere ketyre ambjenteve jane gjetur edhe fatura tatimore shitje te subjektit "Four Beton" me administrator shtetasin Dhimitri Metellari, fatura te cilat ishin te plotesuara dhe nje pjese e te cilave gjendeshin ne tre kopje.Eshte pyetur shtetasi Thodhori Kapurani ne lidhje me kete fakt dhe ai ka deklaruar se nuk kishte dijeni per keto blloqe me fatura te subjektit "Four Beton" dhe se nuk e njihte as administratorin e ketij subjekti.

Eshte kontrolluar subjekti "Four Beton" dhe ka rezultuar qe ai nuk ushtronte aktivitet ne adresen Libonik, Vashtemi, rruga nacionale Korce-Maliq, Km.11, adrese kjo e deklaruar mga ky subjekt ne QKR.
Ne vazhdim te veprimeve hetimore eshte administruar praktika e terheqjes se blloqeve te TVSH-se e ketij subjekti dhe ka rezultuar se ato ishin terhequr nga shtetasi Vangjush Çerepi.
I pyetur ne lidhje me kete rrethane, ky shtetas ka deklaruar se fillimisht punonte si ekonomist te shoqeria "Beçi Company" dhe pas vitit 2012 te gjitha dokumentet e shoqerise ia ka dorezuar ekonomistit tjeter shtetasit Erjon Berberi. Persa i perket subjektit "Four Beton", shtetasi Vangjush Çerepi deklaron se eshte kontaktuar nga shtetasi Dhimiter Metellari, administrator i shoqerise, per te mbyllur bilancin e vitit 2011 te ketij subjekti.

Ne lidhje me vendin e ushtrimit te aktivitetit te kesaj shoqerie, ai ka deklaruar se nuk ka pare te ushtrohej aktivitet dhe se nuk eshte detyra e tij. Ne lidhje me terheqjen e blloqeve te faturave te TVSH-se, shpjegon se ka terhequr blloqe per subjektin "Kapurani Vjara" para shume vitesh, per subjektin "Beçi Company" para disa muajsh dhe per subjektin "Four Beton" ne gusht te vitit 2014. Keto blloqe ai deklaron se ia u ka dorezuar administratoreve te ketyre shoqerive.

Eshte pyetur shtetasi Dhimitri Metellari i cili ka deklaruar se ka kontaktuar ne vitin 2010 me shtetasin grek Dhimiter Vrakopolas qe kishte nje pozicion te rendesishem tek fabrika e çimentos "Antea Çement" dhe se kishin rene dakort qe ai te hapte nje firme dhe te shiste çimenton me te cilen do ta furnizonte "Antea Çement". Me pas i kishin prezantuar shtetasin Vangjush Çerepi si ekonomist dhe me te gjitha veprimet per regjistrimin e firmes dhe per terheqjen e blloqeve eshte marre ekonomisti. Sipas deklaruesit, kjo pune ka vazhduar per 18 muajdhe me pas, shtetasi grek Dhimiter Vrakopolas e ka njoftuar se nuk do punonin me, pa i dhene ndonje arsye. Se bashku me ekonomistin Vangjush Çerepi kane shkuar ne QKR per te bere pezullimin e aktivitetit. Ai deklaron gjithashtu se ne Gusht 2014 ishte njoftuar nga ekonomisti Vangjush Çerepi se i kishin kerkuar nga tatimet e Korces per te aktivizuar firmen, dhe perseri ne muajin Nentor ekonomisti e ka njoftuar se duhej mbyllur firma, pa i dhene arsye per te dyja keto veprime. Ky shtetas deklaron gjithashtu se per periudhen Gusht-Nentor 2014 ai nuk ka firmosur asnje fature tatimore shitje dhe nuk ka kryer asnje veprim ne banke.

Nisur nga dyshimet e krijuara per veprime fiktive mes dy subjekteve, jane verifikuarte dhenat e librave te shit-blerjes te dy subjekteve ne sistemin TAXCRM te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, nga ku rezultoi se nga data 01.08.2014 deri ne date 12.08.2014, subjekti "Beçi Company" kishte realizuar shitje çimento subjektit "Four Beton"ne vlere totale me TVSH prej 77,348,070 lekedhe me pas prej dates 13.08.2014 deri me date 31.08.2014 subjekti "Four Beton" ja kishte rishitur perseri subjektit "Beçi Company" kete sasi çimentoje me te njejten vlere totale.

Nga verifikimi i blloqeve te administruara me procesverbal te kqyrjes ne ambientet e zyres se shoqerise "Beçi Company", ka rezultuar se shumica e faturave te shitjes te bera ndaj subjektit "Four Beton" ne Gusht te vitit 2014 dhe te deklaruara ne librat e shitjes ne sistemin TAXCRM te DPT, ishin me te tre kopjet ne bllok dhe te paplotesuara me te gjitha elementet e saj, te pafirmosura dhe te pavulosura nga ana e perfaqesuesve te dy shoqerive. Gjithashtu po ne keto ambjente jane kqyrur blloqe te shoqerise "Four Beton", ku ka rezultuar se gjithashtu keto blloqe kishin te tre kopjet e faturave te pashkeputura nga blloku dhe nje pjese prej tyre te paplotrsuara me te gjithe elementet e fatures.

Po ashtu, referuar dokumentacionit te ketyre shoqerive, sipas Ekstraktit Historik te Regjistrit Tregtar te QKR, rezulton se subjekti "Four Beton" deri me date 08.08.2014 ka qene me status "Pezulluar",konfirmuar kjo edhe me shkresen Nr.15765 Prot. date 25.08.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçë ku njoftohet subjekti se ka kaluar nga Regjistri Pezullues i Tatimpaguesve ne ate Aktiv me daten 08.08.2014. Pra, subjekti "Beçi Company" ka kryer një pjese te shitjeve me nje subjekt qe nuk ishte aktiv. Nga verifikimet e kryera ekstraktit historik të subjektit "Four Beton" rezulton se veprimet per kalimin fillimisht ne statusin pezulluar dhe me pas ne statusin aktiv, ishin kryer prej shtetasit Erjon Berberi dhe Dhimitri Metellari, administrator i subjektit.

Blloqet e faturave ishin terhequr nga shtetasi Vangjush Çerepi. i cili ka qene ekonomist i te dy ketyre subjekteve per nje periudhe te caktuar kohe, sikurse ka qene edhe i subjektit "Kapurani Vjara".

Nisur nga faktet dhe rrethanat e mesiperme, Prokurorise i ka rezultuar se sasia prej 77.348.070 leke me TVSH, e shitur pa fature tatimore dhe e padeklaruar ne organet tatimore, e ndodhur ne regjistrat kontabel te shoqerise "Beçi Company", perafersisht rreth 6500 ton çimento, i eshte bere shitje fiktive shoqerise "Four Beton", me qellim shmangien e pageses se TVSH-se. Vetem nga ky veprim, vlera e shmangur e TVSH-se eshte 12.891.345 leke.

Pikerisht ne kete periudhe ne subjektin "Beçi Company", ishte duke ushtruar kontroll inspektorja e kontrollit prane Drejtorise Rajonale te Tatimeve Korçë, shtetasja Donika Dimareli, e cila rezulton t'i kete kotrolluar edhe blloqet e faturave te permendura me siper, duke i konsideruar si shitje te rregullta. Pra inspektorja e kontrollit, megjithese ky subjekt i rezultonte me nje sasi te konsiderueshme malli gjendje, ka pranuar te administroje pa i verifikuar nje sere faturash fiktive, te cilat jane bere me qellim qe te perputhej gjendja e inventarit (asnje sasi çimentoje) me te dhenat qe tregonin dokumentat per kete shoqeri, duke mbuluar ne kete menyre shkeljet e ketij subjekti.

Me qellim zbardhjen plote te ketyre shkeljeve. duke qene se te kater subjektet e mesiperme furnizoheshin nga i njejti subjekt "Antea Çement", eshte administruar nga ky subjekt i gjithe dokumentacioni per furnizimin e ketyre subjekteve, transferimi i borxhit etj.
Nga analiza e ketyre dokumentve rezulton se:

-Subjekti "Four Beton", per vitet 2011 dhe 2012 ka blere nga shoqeria "Antea Çe,ment" 2882 ton çimento ne vlere totale me TVSH prej 27.429.542 leke.
Në bliancin e fundit te dorezuar nga ana e kesaj shoqerie, ate te vitit 2012, rezulton se ka pasur gjendje inventari çimento prej 432 ton, me vlerë 3.442.861 leke. Por, nga verifikimi i deklarimeve te bera nga subjekti ne Sistemin Informatik Tatimor (SIT), rezulton se per vitin 2013 ky subjekt nuk ka kryer asnje shitje. Dyshohet se e gjithë sasia e mbartur ne bilanc eshte shitur pa fature tatimore dhe nuk eshte deklaruar duke shmangur pagesen e tatimit. Ky subjekt, gjithashtu eshte perfshire ne nje maredhenie fiktive me shoqerinë "Beçi Company" në muajin Gusht te vitit 2014.

-Subjekti "Beçi Company" ne total per vitin 2014 e deri nedate 07.04.2015 kablere18510 ton çimento me nje vlerë totale me TVSH prej 195,356,996 leke. Me ane te nje veprimi fiktiv, gjate kontrollit nga ana e tatimeve, ky subjekt ka shkarkuar rreth 6500 ton çimento me vlere totale me TVSH 77,348,070 leke, duke ia shitur fiktivisht shoqerise "Four Beton", sasi te cilen me letra e ka riblere dhe duhet ta kete gjendje inventari. Por, nga te gjitha verifikimet e bera gjate procesit te hetimit, kjo sasi çimentoje nuk eshte gjendje, qe do te thote se eshte shitur me pare se subjekti te bente keto levizje, duke mos u deklaruar ne tatime dhe shmangur pagesen e detyrimeve tatimore.

-Subjekti "Kapurani Vjara" per vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 ka blere nga shoqeria "Antea Çement" nje sasi prej 67.072 ton çimento me nje vlere totale me TVSH prej 663,049,900 leke. Me date 18.09.2013 ky subjekt ka kaluar ne stastusin *Pezulluar*. Nga analizimi i bilancit

tedorezuar nga kjo shoqeri per vitin 2013, rezulton se ka gjendje inventari ne vlere prej 25.000 ton çimentome nje vlere prej afro 200,240,000 leke. Nga te gjitha te dhenat qekane rezultuar gjate hetimit, ky subjekt nuk ushtron aktivitet, nuk ka gjendje inventari, ndaj dhe mendohet se gjithe sasia prej 25.000 ton çimento eshte shitur nga ana e ketij subjekti duke mos u deklaruar me qellim shmangien e pageses se tatimit.

-Subjekti "Kapurani Trans", per vitet 2012, 2013 dhe 2014 ka blere nga shoqeria "AnteaÇement" nje sasi prej 48.518 ton çimento me vlere totale me TVSH prej 433,504,930 leke. Edhe per kete shoqeri krijohet dyshimi se ka realizuar shitje te çimetos pa fature tatimore me qellim shmangien nga pagesa e detyrimeve tatimore, pasirezulton te keteme letra nje gjendje prejgati 25.000 ton çimento, te cilen realisht nuk e ka gjendje fizike, por e ka shitur pa fature tatimore me qellim shmangien e pageses se tatimit.
Per kete arsye, me qellim qe te fshiheshin te gjitha keto veprime te paligjshme, ne date 30.01.2014, pasi me pare ka marre persiper detyrimet e "Kapurani Vjara" dhe ka bere kalimin e mjeteve te transportit tek "Beçi Company", eshte bere edhe shitje fiktive e kesaj shoqërie shtetasit italian Enzo Martini.

Ne vijim te veprimeve hetimore, ju jane marre deklarime adminstratoreve te disa subjekteve te cilet kane pasur maredhenie tregtare me subjektet "Four Beton", "Kapurani Trans", "Kapurani Vjara" dhe "Beçi Company", e konkretisht shtetasve Viktor Qylafi administrator i "Favina" sh.p.k, shtetasit Aurel Xega perfaqesues ligjor i subjektit "Thoreneks" sh.p.k, shtetasit Edmond Dako perfaqesues ligjor i subjektit "3 D" sh.p.k, Hysen Çajka perfaqesues ligjor i subjektit "Floda 1" sh.p.k, shtetasit Ndue Kola perfaqesues ligjor i subjektit "ANK", te cilet kane deklaruar se njohin shtetasin Foto Kapurani si pronar te këtyre subjekteve pasi me ate kane komunikuar per blerjen e çimentos.

Kurse pas administrimit te te dhenave te ardhura nga bankat e nivelit te dyte, ka rezultuar se administratoret e ketyre kater subjekteve, kane bere derdhje cash dhe pagesa te ndryshme per subjektet ne te cilat nuk kane qene administratore.
Keshtu, ne Nentor te vitit 2013,reaulton kalimfondesh nga llogaria personale e Arjan Seferit ne favor te shoqerise "Kapurani Trans" (si i autorizuar nga shoqeria). Po ashtu rezultojne kalim fondesh nga Sotiraq Beçi per Arjan Seferin.
Nga verifikimii llogarise bankare tesubjektit "Four Beton", ne Alpha Bank rezulton se Sotiraq Beçi (perfaqesues i "Beçi Company") ka kryer pagesa tatimesh nepermjet kesaj llogarie.
Po ashtu rezultojne derdhje nga Arjan Seferi tek subjekti "Kapurani Vjara", derdhje nga Sotiraq Beçi te"Kapurani Vjara" (per periudhen 2009-2010) ne vlera te konsiderueshme, si edhe derdhje nga shume persona te tjere qe dyshohet se jane shofereapo punonjes tepunesuar prej Foto Kapuranit ne keto shoqeri.

Po ashtu i eshte kerkuar informacion ne lidhje me asetet e ketyre shoqerive Drejtorise te Pergjithshme te Sherbimit te Transportit Rrugor, e cilame shkresen nr. 6117/1 Prot.Date 25.05.2015 informon ne lidhje me mjetet ne pronesi te kater shoqerive te siperpermendura dhe te administratoreve te tyre.
Pas sekuestrimit te ketyre dosjeve dhe studimit te dokumentacionit te tyre ne lidhje me kalimet e pronesise, ka rezultuar se keto automjete kane kaluar nga njera shoqeri ne tjetren midis ketyre kater shoqerive, duke u bere here pas here shitje dhe kalime nga njera tek tjetra.

Nga teresia e veprimeve hetimore te kryera dhe te dhenave qe kane rezultuar, Prokuroria ka arritur ne perfundimin se te kater subjektet tregtare "Kapurani Vjara", "Kapurani Trans", "Beçi Company" dhe "Four Beton", jane krijuar dhe administruar faktikisht nga shtetasi Foto Kapurani, i cili ka vendosur formalisht si administratore rrethin e ngushte familjar, por ne fakt asetet jane disponuar prej tij.

Te kater keto subjekte kane funksionuar me te vetmin qellim shmangin e detyrimeve tatimore per TVSH-ne dhe megjithse referuar deklarimeve dhe dokumentacionit tatimor, duhet te kishin mall gjendje, nga hetimet e kryera ka rezultuar se ato nuk kane, pasi e kane shitur ne treg te zi dhe per te justifikuar kete fakt, kane kryer nje sere transaksionesh fiktive me njera-tjetren. Gjithashtu rezulton se keto kompani (me përjashtim te "Beçi Company" e cila sot figuron me administrator djalin e Foto Kapuranit), pasi ngarkoheshin me borxhe ne vlera te konsiderueshme, kryenin pezullimin e tyre ose shiteshin fiktivisht tek persona te tjere, sikurse eshte rasti imarrjes persiper te detyrimeve te "Kapurani Vjara" nga "Kapurani Trans" e pastaj shitjen e kesaj shoqerie tek shtetasi italian Enzo Martini.

Kontrata per shitjen e shoqerise "Kapurani Trans" duket se eshte nje kontrate fiktive, e bere me qellim shmangjen e detyrimeve tatimore, edhe per faktin se me pare ishin bere kalimet e aseteve reale nga kjo shoqeri tek shoqeria "Beçi Company" (pra eshte shitur nje shoqeri pa asete dhe e mbingarkuar me detyrime).

Me marreveshjen e dates 25.05.2012, e lidhur midis paleve "Antea Cement", "Kapurani Trans" dhe "Kapurani Vjara" rezulton se detyrimet ne vlera te konsiderueshme te shoqerise "Kapurani Vjara" me administrator Foto Kapurani ndaj shoqerise"Antea Cement" ka marre persiper t'i shlyeje shoqeria "Kapurani Trans" me administrator ne ate periudhe shtetasin Naim Zeneli (ky i fundit rezulton te jete thjesh nje shofer), te cilin shtetasi Foto Kapurani e ka vendosur formalisht ne ate periudhe si administrator te shoqerise "Kapurani Trans".

Nga analizimi i dosjeve te mjeteve te ketyre shoqerive, rezulton se pjesa me e madhe e tyre jane transferuar nga njera shoqeri ne tjetren, nepermjet kontratave te shitblejeve te dyshimta, duke bere kalimin e tyre ne funksion te skemes mashtruese te TVSH-se.

Nga deklarimet e marra, vërtetohet njohja midis administratorëve të këtyre shoqërive tyre dhe identifikohet shtetasi Foto Kapurani si pronar real i aseteve te ketyre shoqerive dhe te vete shoqerive.

Nga sa me siper rezulton se shtetasi Foto Kapurani, me ndihmen e shtetasve Jorgji Ziko (nipi i tij), Sotiraq Beçi (ish dhendri i tij), Dhimitri Metellari (administrator i "Four Beton") dhe shtetasit Vangjush Çerepi (i cili ka qene ekonomist dhe pike kontakti e tij per Drejtorine Rajonale Tatimore Korçë), ka krijuar nje skeme mashtruese per te shmangur detyrimet qe lindin nga TVSH, dhe per kete qellim dyshohet se eshte ndihmuar edhe nga punonjes te administrates tatimore, te cilet nuk duhet te kishin lejuar nje fenomen te tille.

Duke ju referuar sa me siper, Prokuroria ka filluar procedimin penal dhe eshte duke hetuar per vepren penale te "Krijimit te skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vleren e shtuar" te parashikuar nga neni 144/a i K.Penal, duke regjistruar si persona qe i atribuohet kjo veper shtetasit Foto kapurani, Sotiraq Beçi, Jorgji Ziko, Dhimitri Metellari, Vangjush Çerepi, si edhe per vepren penale te "Fshehjes se te ardhurave" parashikuar nga neni 180 i K.Penal, duke regjistruar procedimin ne emer te shoqerive tregtare "Kapurani Vjara", "Kapurani Trans", "Beçi Company" dhe "Four Beton".

Faktet e mesiperme rezultojne nga aktet shkresore te paraqitura nga Prokuroria dhe te shqyrtuara ne seance gjyqesore:

-Urdher per regjistrimin e emrit te personave qe ju atribuohet vepra penale,date 28.07.2015,
- Vendim per bashkimin e procedimeve penale,date 25.05.2015,
- Urdher per regjistrimin e procedimit penal date 23.04.2015,
- Urdher per regjistrimin e procedimit penal date 06.05.2015,
- Shkresa nr. 2697 dt. 25.05.2015 e Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se pare Korçe, drejtuar Drejtorise te Hetimit Tatimor, Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve,
- Urdher per kryerjen e veprimeve hetimore, date 25.05.2015,
- Shkresa nr.1207prot dt. 04.05.2015, e Drejtorise se Hetimit Tatimor Rajoni Qendror,
- Informacion per referimin e vepres penale. date 27.04.2015,
- Ekstrakti historik i regjistrit tregetar per subjektin "Four Beton",
- Ekstrakti historik i regjistrit tregetar per subjektin "Beçi Company",
- Ekstrakti historik i regjistrit tregetar per subjektin "Kapurani Vjara",
- Ekstrakti historik i regjistrit tregetar per subjektin "Kapurani Trans",
- Kontrate shitblerje nr. 193 rep 59/4 kol. e datës 31.01.2014 me pale Jorgji Ziko e Enzo Martini per shitjen e kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Kapurani Trans,
- Procesverbal per kqyrjen dhe marrjen e provave materiale, date 30.03.2015 (blloqet e faturave te gjetura ne zyrat e subjektit "Beçi Company"),
- Procesverbal per kqyrjen dhe marrjen e provave materiale, date 30.03.2015 (blloqet e faturave te gjetura ne zyrat e subjektit "Beçi Company"),
- Procesverbal per kqyrjen dhe marrjen e provave materiale date 15.04.2015 (dokumentacioni i dorezuar nga subjekti "Antea Cement"),
- Procesverbal per kqyrjen dhe marrjen e provave materiale, date 24.04.2015 (dokumentacioni i dorezuar nga subjekti "Antea Cement" per subjektet "Kapurani Vjara", "Kapurani Trans", "Four Beton" dhe "Beci Company",
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date28.03.2015 dhe date 20.04.2015, i shtetases Donika Dimareli,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 28.03.2015 dhe date 01.04.2015, i shtetasit Vangjush Çerepi,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 02.04.2015, i shtetasit Dhimitri Metellari,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 21.04.2015, i shtetasit Erion Berberi,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 30.03.2015, i shtetasit Thodhori Kapurani,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 15.07.2015, i shtetases Matilda Hoxhalli,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 13.07.2015, i shtetasit Foto Kapurani,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 13.07.2015, i shtetasit Arjan Seferi,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 10.06.2015, i shtetasit Afrim Ismaili,

- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 09.06.2015, i shtetasit Hysen Çajka,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 29.06.2015, i shtetasit Ndue Kola,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 17.06.2015, i shtetasit Viktor Qylafi,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 17.06.2015, i shtetasit Aurel Xega,
- Procesverbal per marrjen e te dhenave nga personi qe ka dijeni per rrethanat e hetimit, date 14.06.2015, i shtetasit Edmond Dako,
- Akt konstatimi date 27.03.2015 (per mungesen e aktivitetit te subjektit Beçi Company ne adresen e deklaruar ne QKR),
- Akt konstatimi date 30.03.2015 (per mungese sasie cimentoje ne shoqerine Beçi Company),
- Akt konstatimi date 01.04.2015 (per mungesen e aktivitetit te subjektit Four Beton ne adresen e deklaruar ne QKR),
- Formular i furnizimit me fatura tatimore (terhequr nga Vangjush Çerepi si perfaqesues per subjektin Four Beton),
- Raport perfundimtar kontrolli per subjektin "Beçi Company",
- Akt Marreveshje e dates 01.06.2010,
- Procesverbal dorezim dokumentacioni, date 14.04.2015,
- Tabele permbledhese e faturave te shitjes per subjektin "Four Beton", marre nga "Antea Cement" sh.a,
- Tabele e detajuar e faturave te shitjes per subjektin "Four Beton", marre nga "Antea Cement" sh.a,
- Tabele permbledhese e faturave te shitjes per subjektin "Beçi Company", per vitet 2014-2015, marre nga "Antea Cement" sh.a,
- Tabele e detajuar e faturave te shitjes per subjektin "Beçi Company", marre nga "Antea Cement" sh.a, per vitet 2014-2015,
-Tabele permbledhese e faturave te shitjes per subjektin "Beçi Company", per vitet 2010-2015,
- Tabele e detajuar e faturave te shitjes per subjektin "Beçi Company", marre nga "Antea Cement" sh.a, per vitet 2010-2015,
- Tabele permbledhese e faturave te shitjes per subjektin "Kapurani Vjara", per vitet 2009-2012,
- Tabele e detajuar e faturave te shitjes per subjektin "Kapurani Vjara", marre nga "Antea Cement" sh.a, per vitet 2009-2012,
- Procesverbal dorezim dokumentacioni me nr. 255/3prot date 23.04.2015,
- Tabele permbledhese e faturave te shitjes per subjektin "Kapurani Trans", per vitet 2012-2014,
- Tabele e detajuar e faturave te shitjes per subjektin "Kapurani Trans", marre nga "Antea Cement" sh.a, per vitet 2012-2014,
- Procesverbal per sekuestrimin e sendeve, date 18.06.2015,
- Procesverbal i kqyrjes se vendit te ngjarjes, date 02.07.2015,

- Marreveshje e dates 25.05.2012 midis "Antea Cement" sh.a. "Kapurani Vjara" dhe "Kapurani Trans" (per kalimin e detyrimeve te pashlyera nga subjekti "Kapurani Vjara" tek subjekti "Kaputrani Trans",
- Pasqyrat financiare te subjekteve "Beçi Company", "Four Beton" dhe "Kapurani Vjara",
- Fotokopje te kater blloqeve te faturave, qe ju përkasin subjekteve "Beçi Company" dhe "Four Beton",
- Relacion i Oficerit tePolicise Gjyqesore date 27.07.2015.

Nga sa me siper, duke mbajtur parasysh kushtet per caktimin e mases te sigurimit pasuror te sekuestros konservative te parashikuara nga neni 270 i K.Pr.Penale, gjykata vlereson se ka vend qe te pranohet kerkesa per caktimin e nje mase te tille.

Neni 270/1 i K.Pr.Penale percakton se: "*Kur ka arsye te bazuara per te menduar se nuk ka garanci per pagimin e denimit me gjobe, te shpenzimeve te procedimit dhe te cdo detyrimi ndaj pasurise te shtetit, prokurpri kerkon sekuestron konservative te pasurise te luajtshme ose te paluajtshme te te pandehurit ose te shumave a sendeve qe te tjeret i detyrohen atij, ne caqet qe ligji lejon sekuestrimin e tyre*".

Duke ju referuar demit qe i eshte shkaktuar shtetit nga fshehja dhe mospagimi i detyrimeve tatimore, i cili mendohet te jete rreth 170 milion leke, eshte e nevojshme vendosja e sekuestros konservative per te garantuar detyrimet e ketyre subjekteve ndaj shtetit, pasi kjo pasuri qe ato kane ne formen e aseteve, mund te transferohet apo tjetersohet, me qellim shmangien e pagimit te detyrimeve ndaj shtetit, sikurse ka ndodhur edhe me pare nga veprimet qe keto subjekte kane kryer, duke bere kalimin e kamionave nga njera shoqeri tregtare ne tjetren, para se te pezullohej aktiviteti i ketyre shoqerive.
Nga ana tjeter, keto kamiona qe ende rezultojne ne pronesi te ketyre shoqerive, mund te garantojne nje pjese te detyrimeve qe keto shoqeri kane ndaj shtetit, ndaj ka rrezik qe disponimi i lire i ketyre kamionave mund te rendoje pasojat e kesaj vepre, pasi ato mund te transferohen, tjetersohen apo te fshihen nga ana e shtetasve te dyshuar, me qellim shmangien e detyrimeve tatimore dhe borxhit qe kane ndaj buxhetit te shtetit.

Gjykata vlereson se masa e sigurimit pasuror te sekuestros konservative, i pergjigjet te gjitha kushteve ligjore dhe eshte ne perputhje me rendesine e faktit dhe shkallen e nevojave te marrjes te nje mase te tille per rastin konkret.

PËR KËTO ARSYE

Ne baze te nenit 270 dhe 278 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Pranimin e kerkeses te Prokurorise prane Gjykates te Shkalles se Pare Korce.

-Vendosjen e mases te sigurimit pasuror "sekuester konservative" mbi sendet e meposhtme:

1. Kamioni koke terheqese tip SCANIA, me ngjyre te bardhe, me targa AA858AM, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

2. Kazani i kamionit ose gjysem rimorkio me targa ABR870, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

3. Gjysem rimorkio marka KASSBOHRER me ngjyre te bardhe me targa ACR198, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

4. Gjysem rimorkio marka KRONE me ngjyre te bardhe me targa ABR220, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

5. Koke terheqese marka VOLVO me ngjyre te bardhe me targa AA748DL, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

6. Koke terheqese marka SCANIA me ngjyre te kuqe me targa AA544GE, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

7. Koke terheqese marka SCANIA me ngjyre te kuqe me targa AA891GY, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

8. Koke terheqese marka SCANIA me ngjyre te kuqe me targa KO7598B, ne pronesi te shoqerise "Four Beton" ;

9. Gjysem rimorkio marka SHMITZ me ngjyre te kuqe me targa KO9735B, ne pronesi te shoqerise "Kapurani Vjara" ;

10. Gjysem rimorkio marka EBIESK me targa KO4476B, ne pronesi te shoqerise "Kapurani Vjara" ;

11. Gjysem rimorkio marka SHMITZ me targa AA874AF, ne pronesi te shoqerise "Kapurani Vjara" ;

12. Koke terheqese marka SCANIA me ngjyre te bardhe me targa AA166AT, ne pronesi te shoqerise "Kapurani Vjara" ;

13. Koke terheqese marka VOLVO me ngjyre te bardhe me targa AA812AF, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

14. Gjysem rimorkio marka VIBERTI me targa AA813AF, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

15. Koke terheqese marka SCANIA me ngjyre te bardhe me targa KO9284B, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

16. Koke terheqese marka VOLVO me ngjyre te bardhe me targa AA355FL, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

17. Koke terheqese marka SCANIA me ngjyre te bardhe me targa AA912BH, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

18. Gjysem rimorkio marka KAISER me targa KO9717B, ne pronesi te shoqerise "Four Beton" ;

19. Koke terheqese marka SCANIA me ngjyre jeshile me targa AA952FI, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

20. Gjysem rimorkio marka KRONE me targa KO9285B, ne pronesi te shoqerise "Beçi Company" ;

21. Automjeti me targe AA357FD, i regjistruar ne Drejtorine Rajonale te Sherbimit te Transportit Rrugor Tirane ;

22. Automjeti me targe ABR316, i regjistruar ne Drejtorine Rajonale te Sherbimit te Transportit Rrugor Durres.

-Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Korce, brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes, per subjektet e interesuara afati fillon nga e nesermja e venies ne dijeni lidhur me kete vendim.

U shpall ne Korce, ne date 13.08.2015.

SEKRETARE
Vasjana POSTOL

GJYQTARE
Luljeta KOLE

VERTETOHET
NJESIA E
FOTOKOPJES
ME ORIGJINALIN që ndodhet në dosje
KORCE ME 25.11.2020
Arkiviste Marinela Cenolli

KANCELARE
LUBIANA KINOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT KORÇË